



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 218/1 Prot.

Tiranë, më 07. 02. 2018

**V E N D I M**

**Nr. 45, Datë 07. 02. 2018**

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa numër 163, datë 19.12.2017, e bërë nga L. Ç., kundër Sekretares së Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, në të cilën pretendon diskriminim për shkak ngjyrës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

Sipas pretendimeve të parashtruara në ankesë, L. Ç. sqaron se në muajin dhjetor 2017, është paraqitur pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë dhe pranë sekretarisë ka kërkuar të takohet me punonjësën e këtij institucioni shtetasen E. Sipas tij, sekretarja e këtij institucioni i është drejtuar me një sjellje fyese dhe diskriminuese për shkak të ngjyrës.

Pësa më lart, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi marrjen e informacionit mbi arsyen e kësaj sjellje, nga sekretarja e Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë dhe të merren masa deri në largimin e saj nga puna.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se ankuesi nuk kishte vënë në dispozicion të Komisionerit informacion të mjaftueshëm për të vijuar me shqyrtimin e ankesës, lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe diskriminues nga ana e sekretares së Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë. Në këto kushte, Komisioneri iu drejtua ankueses me anë të shkresës nr. 1266/1 prot., datë 26.12.2017, ku për efekt të shqyrtimit të ankesës së depozituar nga ana e tij, i kërkohej informacion lidhur me shkakun e diskriminimit dhe mundësinë e përcaktimit të subjektit ndaj të cilit ka paraqitur ankesën.

Për sa më sipër, ankuesi është vënë në dijeni<sup>1</sup> të shkresës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 1266/1 prot., më datë 27.12.2017. Pas marrjes dijeni, ankuesi nuk dërgoi informacionin e kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Megjithatë, strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke qënë se Tirana ka dy drejtori arsimore, Drejtoria Arsimore Rajonale e Qytetit Tiranë dhe Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, kërkoi të administrojë informacionin lidhur me të dhënat e punonjësve të këtyre institucioneve në faqet web: [www.dartiraneqytet.edu.al](http://www.dartiraneqytet.edu.al) dhe [www.dartiraneqark.edu.al](http://www.dartiraneqark.edu.al), në mënyrë që të evidentonte subjektin ndaj të cilit ankohet L. Ç., por nuk u arrit të sigurohej një informacion i tillë në faqet respective të web-it.

**Në këto kushte, pas analizimit të ankesës nr. 163, datë 19.12.2017, Komisioneri konstatoi se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” përcaktohet një listë joshterruese shkaqesh diskriminimi, ku në çdo rast pala ankuese duhet të japë argumentimet përkatëse, të cilat të krijojnë një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit të pabarabartë dhe disfavorizues, që ajo pretendon se është ndërmarrë ndaj vajzës së saj, me këtë shkak diskriminimi.

Në këto kushte, në mungesë të provave të kërkuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të dhënë informacion lidhur me shkakun e diskriminimit dhe evidentimin më të saktë të subjektit ndaj të cilit ka paraqitur ankesën, nuk është e mundur që të iniciohet procesi i hetimit administrativ.

Për sa më sipër, nga pikëpamja formale, Komisioneri vlerësoi se ankesa nr. 163, datë 19.12.2017, e L. Ç. nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në nenin 33, pika 4, gërma ç), parashikohet se :

*“Ankesa nuk pranohet nëse:*

*a).....*

*b).....*

*c).....*

*ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;*

Për sa më sipër, duke analizuar në tërësi ankesën nr. 163, datë 19.12.2017, e L. Ç., Komisioneri gjykoi se për rastin konkret nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.

<sup>1</sup> Referuar Lajmërim-Marrjes së Postës Shqiptare dt. 27.12.2017

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 3, 12, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 163, datë 19.12.2017, e L. Ç., pasi ankesa nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

**KOMISIONERI**

---

**Irma BARAKU**

(Shkaku: Ngjyra)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)